



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATURA E SHETIT  
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. 3647 Prot.

Datë 06 / 07 / 2023

U R D H Ë R

Nr. 348, datë 06.07.2023

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN E BRENDSHME “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AVOKATURËS SË SHETIT” TË MIRATUAR ME URDHRIN NR. 68, DATË 28.03.2019 TË AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM TË SHETIT”**

Në mbështetje të shkronjave “a”, “c” dhe “k” të nenit 6 të ligjit nr. 10 018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” të ndryshuar, Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Avokaturës së Shtetit” të miratuar me urdhrin nr. 68 datë 28.03.2009 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit,

U R D H Ë R O J :

1. Në Rregulloren e Brendshme për Organizimin dhe Funkcionimin e Avokaturës së Shtetit bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
2. Pas nenit 19 shtohet neni 19/1 me këtë përmbajtje:

**“Raporti i inspektimit**

1. Raporti i inspektimit, është raporti i brendshëm nëpërmjet të cilit avokatët e shtetit pranë Zyrës së Inspektimit, i paraqesin Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit rezultatet e veprimtarisë së inspektimit, gjetjet, konstatimet, detyrat, rekomandimet dhe propozimet përkatëse për fillimin e ecurisë disiplinore dhe marrjen e masave disiplinore.
2. Raporti i inspektimit nuk mund të rishikohet nga Zyra e Inspektimit, me përjashtim të rasteve kur Avokati i Përgjithshëm i Shtetit e kërkon një gjë të tillë.
3. Raporti i inspektimit, nuk pengon fillimin e një inspektimi të ri, për fakte dhe ngjarje për të cilat Zyra e Inspektimit ka ardhur në dijeni pas nxjerrjes së raportit përfundimtar, me kushtin që inspektimi të mos kryhet për të njëjtat fakte dhe për të njëjtën çështje të trajtuar më parë.
4. Në rastet kur Avokati i Përgjithshëm i Shtetit kërkon fillimin e procedimit disiplinor, i dërgon Komisionit të Disiplinës kërkesën së bashku me Raportin e Inspektimit.”

3. Në nenin 53 bëhen këto ndryshime:

Pika 3 ndryshohet në këtë mënyrë:

“3. Komisioni i disiplinës, brenda dhjetë ditëve pune nga dita e paraqitjes së kërkesës së Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, fillon procedimin disiplinor dhe i njofton Raportin e Inspektimit avokatit të shtetit që ka kryer shkeljen, duke i lënë afat deri në shtatë ditë pune për dërgimin e observacioneve me shkrim.”

Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Pas përfundimit të afatit për paraqitjen e observacioneve me shkrim, Komisioni i Disiplinës njofton avokatin e shtetit për t'u paraqitur në seancë dëgjimore, jo më vonë se pesë ditë pune nga data e përfundimit të afatit.

Pika 4 ndryshohet në këtë mënyrë:

“4. Komisioni i disiplinës, pasi ka përfunduar procedurën e hetimit administrativ, i paraqet Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit raportin përfundimtar, së bashku me propozimin për masën disiplinore, jo më vonë se pesë ditë pune. Afati për paraqitjen e raportit përfundimtar mund të zgjatet për shkaqe të përligjura dhe pas miratimit të dhënë me shkrim nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.”.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**  
**ODISE MOCKA**

